

FORCA E PUNËS

(Sipas të dhënave të Anketës për Forcën e Punës, 2008)


Gjatë muajve Shtator - Tetor 2008 Instituti i Statistikave të Shqipërisë kreu për të dytën herë Anketën e Forcave të Punës pranë familjeve në nivel kombëtar. Objektivi kryesor i Anketës është ngritja e një sistemi të qëndrueshëm statistikor të statistikave për forcën e punës në përputhje me standartet ndërkombëtare. Nëpërmjet kësaj ankete mundësohet ndarja e popullsisë 15 vjeç e lart në tre grupe të veçanta - të punësuarit, të papunët dhe personat inaktivë në lidhje me tregun e punës, si edhe sigurohen të dhëna përshkruese dhe shpjeguese për secilën nga këto kategori.

Në bazë të të dhënave të Anketës për Forcën e Punës 2008, popullsia në moshë 15-64 vjeç përbën 84.5% të popullsisë 15 vjeç e lart.

Punësimi

Në vendin tonë gjatë muajve Shtator – Tetor 2008, në bazë të të dhënave të Anketës për Forcën e Punës dhe në përputhje me definicionin e EUROSTAT-it dhe Organizatës Ndërkombëtare të Punës për punësimin, rezultojnë rreth 1,123 mijë të punësuar në moshë 15 vjeç e lart ose 1,103 mijë të punësuar në moshë 15-64 vjeç.

Shkalla e punësimit në nivel vendi për popullsinë në moshë 15-64 vjeç rezulton 53.8%. Niveli i punësimit është më i lartë për meshkujt me 63 % krahasimisht me femrat me 45.5%. Ky tregues është më i lartë për meshkujt e të gjitha grupmoshave.




Në vitin 2008, të punësuarit 15 – 64 vjeç me arsim tetëvjeçar përbëjnë 49.4% të popullsisë në moshë pune me arsim tetëvjeçar, ndërsa shkalla e punësimit për personat me arsim të mesëm dhe me arsim të lartë është përkatësisht 55.6% dhe 75.1%


Të punësuar (15 - 64 vjeç) sipas sektorëve dhe gjinisë, 2007-2008

(Në përqindje)

	2007			2008		
	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Meshkuj	Femra	Gjithsej
Gjithsej	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0	100.0
Spektori shtetëror	15.1	15.4	15.2	18.0	18.7	18.3
Spektori privat bujqësor	36.7	60.4	47.2	33.3	55.8	43.4
Spektori privat jo bujqësor	48.3	24.1	37.6	48.7	25.5	38.3



Struktura e punësimit sipas sektorëve për të punësuarit në moshë 15-64 vjeç tregon që punësimi në sektorin shtetëror zë përqindjen më të ulët të punësimit gjithsej. Femrat e punësuar kanë një pjesëmarrje më të madhe në sektorin privat bujqësor, ndërkohë që meshkujt janë më të angazhuar në sektorin privat jo-bujqësor (femrat përbëjnë vetëm afro ¼ e të punësuarve në sektorin privat jo-bujqësor).




Në vitin 2008, struktura e punësimit sipas aktiviteteve ekonomike tregon një përqëndrim më të lartë të të punësuarve në: bujqësi (44.7 %), tregëti (11.7 %), industri përpunuese (7.1 %), ndërtim (8.4 %).

Ndërsa struktura e punësimit sipas grup-profesioneve, klasifikuar sipas nomenklaturës ISCO 88, paraqet një përqëndrim më të lartë të të punësuarve në grupin e madh “Punëtorë të kualifikuar të bujqësisë dhe peshkimit” me 43.5 %, pasuar nga grupi “Zejtarë dhe punëtorë të zanateve të ndryshme” me 10.6 % dhe grupi “Punëtorë të shërbimeve, shitblerjeve dhe dyqaneve” me 9.9 %.

Papunësia

Gjatë muajve Shtator – Tetor 2008 numëroheshin rreth 166 mijë të papunë përlogaritur në përputhje me definicionin e ILO-s dhe të EUROSTAT-it. Shkalla e papunësisë për këtë periudhë është 13 %. Shkalla e papunësisë është më e lartë në grupmoshat e reja deri në rreth 30 vjeç. Ky tregues për grupmoshat 30-49 vjeç është më i lartë për femrat sesa për meshkujt; nga ana tjetër në grupmoshat pas 55 vjeç vihet re një tendencë më e lartë për të kërkuar punë tek meshkujt.

Mënyra kryesore nëpërmjet së cilës të papunët kanë kërkuar punë në vitin 2008 në vendin tonë është “nëpërmjet miqve/shokëve dhe të afërmeve” ku rezulton se 78.6 % e të papunëve kanë kërkuar punë nëpërmjet kësaj mënyre. Kjo metodë pasohet nga “aplikuar direkt tek ndonjë punëdhënës” (39.9 %), “nëpërmjet kërkimit në zyrën e punës” (35.8 %), “studiuar lajmërimet në gazeta” (22 %).



Popullsia inaktive në moshë 15-64 vjeç

Në vitin 2008, inaktivët në moshë 15-64 vjeç përbëjnë rreth 38.1% të kësaj popullsie. Kjo përqindje relativisht e lartë rezulton kryesisht si pasojë e:

- 34.1% e inaktivëve përbëhen nga nxënësit dhe studentët,
- ka një numër të konsiderueshëm personash pa punë por që nuk kërkojnë punë sepse “besojnë që nuk ka punë të disponueshme”, pra që janë të papunë të dekurajuar (16.1%).
- ka gjithashtu një numër të konsiderueshëm shtepiakësh (13.4%).
- rreth 18% e inaktivëve përbëhen nga persona në pension

Cila është arsyeja kryesore pse ju nuk po kërkonti punë? (%)	Viti		Në cilën prej kategorive do ta klasifikonit veten? (%)	Viti	
	2007	2008		2007	2008
Në arsim ose trainim	38.8	34.1	Nxënës, student, në trainim të mëtejshëm	38.8	34.3
Beson që nuk ka punë të disponueshme	16	16.1	I papunë	22.9	23.6
Përgjegjësi familjare	15	15.2	Në pension ose pension të parakohshëm ose keni hequr dorë nga biznesi	14.6	18.3
Në pension	14.2	18.1			
Sëmundje, paaftësi	9.2	9.9	Duke përmbushur detyrat shtëpiake	13.6	13.4
Tjetër	6.8	6.6	Tjetër	10.1	10.4

Të papunë të dekurajuar janë personat në moshë pune të aftë për të punuar por që nuk kanë kërkuar punë në katër javët para datës së intervistës sepse “besojnë që nuk ka punë të disponueshme”. Ata përfshihen në pjesën inaktive të popullsisë në moshë pune. Nga anketa rezulton që 73.2% e të papunëve të dekurajuar janë femra.

Metodologji dhe Definicione

Anketa për Forcën e Punës është anketë pranë familjeve. Si bazë të dhënash për kampionimin shërbeu Regjistri i Popullsisë 2001. Masa e kampionit të zgjedhur për anketim ishte 7456 familje në të gjithë vendin. Zgjedhja ishte dy-hapëshe; në hapin e parë u zgjedhën zonat gjeografike (PSU) dhe në të dytin familjet brenda këtyre zonave të zgjedhura me short (pasi u realizua procesi i azhurnimit të tyre).

Grumbullimi në terren i të dhënave u krye gjatë muajve Shtator –Tetor 2008. Shkalla e përgjigjes rezultoi 89.3%, pra iu përgjigjën anketes 6662 familje, tregues mjaft i mirë për anketa të tilla. Përsa i përket statusit në lidhje me punësimin, në çdo familje u anketuan nëpërmjet intervistës së drejtpërdrejtë të gjithë pjesëtarët në moshë 15 vjeç e lart.

Nga ana metodologjike anketa plotëson kërkesat e EUROSTAT-it si ato që lidhen me përfaqësimin e kampionit, koeficientët e variacionit të treguesve kryesorë, desinjimin dhe peshimin e skedarit-it të të dhënave.

Pyetësori u hartua me asistencë teknike të EUROSTAT-it dhe ai është në përputhje të plotë me rekomandimet e Eurostat për periudhën 2008 e në vazhdim. Për klasifikimin e personave 15 vjeç e lart në kategoritë përkatëse në lidhje me pjesëmarrjen në tregun e punës u zbatuan definicionet e ILO dhe EUROSTAT. Konkretisht:

Të punësuar janë konsideruar personat që kanë kryer një punë qoftë dhe një orë kundrejt një page ose përfitimi gjatë javës së referencës. Janë konsideruar si të punësuar edhe personat që marrin pagë për trajnimin gjatë punës. Të punësuar janë konsideruar edhe personat që kanë munguar përkohësisht në punën e tyre gjatë javës së referencës për arsye: (1) leje lindje, sëmundje lëndim apo paaftësi e përkoshme dhe presin të kthehen në punë, në shkollim/trainim të lidhur direkt me punën aktuale; (2) të punësuarit me pagë që kanë munguar në punë për arsye të tjera nga të mësipërmet që (a) kohëzgjatja e mungesës është tre muaj ose më pak dhe personi nuk është punëtor sezonal ose (b) personi merr 50% ose më shumë të pagës; (3) të vetëpunësuarit që kanë ndërmend të rikthehen në biznesin/fermën/praktikën profesionale; (4) punëtorët pa pagesë që presin të kthehen në punë në tre muaj ose më pak.

Personat të cilët punojnë në fermën e tyre të vogël, të cilët nuk shesin produktet e tyre, por prodhojnë vetëm për vetëkonsum, janë konsideruar të punësuar.

Të papunë konsiderohen personat që ishin:

- (a) *pa punë gjatë javës së referencës* (as nuk kishin një punë dhe as kryen ndonjë punë (për një orë ose më shumë) kundrejt një page ose përfitimi.
- (b) *aktualisht të disponueshëm për të punuar* (brenda dy javëve që pasojnë javën e referencës).
- (c) *duke kërkuar punë në mënyrë aktive* (gjatë periudhës katër javore që përfundon me javën e referencës kishin ndërmarrë hapa specifike për të kërkuar punë me pagë ose për të ngritur një biznes të tyre) *ose kishin gjetur një punë që do ta fillonin së shpejti* (brenda një periudhe prej të shumtën tre muaj).

[si hapa specifike për të kërkuar punë konsiderohen:

- kontakt me një zyrë publike punësimi për të gjetur punë
- kontakt me një agjensi private punësimi për të gjetur punë
- aplikim direkt pranë ndonjë punëdhënësi
- kërkuar miqve/shokëve, të afërmeve, sindikatave etj.
- vendosur ose përgjigjur lajmërimeve në gazeta
- studiuar lajmërimet në gazeta

- marrë pjesë në një test apo intervistë
- kërkuar për tokë, godinë ose pajisje
- aplikuar për leje, liçenca ose burime financiare]

Forca e Punës përfshin personat e punësuar dhe të papunë.

Popullsia në moshë pune është popullsia 15 – 64 vjeç.

Popullsia jo aktive përfshin të gjithë personat të cilët nuk janë klasifikuar si të punësuar ose të papunë (nxënës/studentë, shtëpiakë, në shërbim të detyrueshëm ushtarak, në pension, të paaftë, të papunë të dekurajuar).

Niveli i punësimit është raporti i të punësuarve 15 - 64 vjeç kundrejt popullsisë në moshë pune.

Shkalla e papunësisë është raporti i të papunëve kundrejt forcës së punës.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcën e punës është raporti i forcës së punës kundrejt popullsisë në moshë pune.